



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1611/ 2 prot

Datë 11.07.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekti:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Trimed*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur*” me tender kryesor nr REF-71219-05-31-2023 ku ankimon Lotin 2 me objekt “**LOTI 2 F.V. PAJISJE SPITALORE PER URGJENCEN E SPITALIT RAJONAL VLORE**” me nr REF-71223-05-31-2023 me fond limit 6,633,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 23-06-2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Trimed*” SHPK
Autostrada Tirane -Durrës , Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr.Pasurie 95/11.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore.
Lagjja : “ Partizani “

Në datën 10.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë elektronike në Sistemin e Ankesave Elektronike ankesa me nr. A/2023/3255 , protokolluar me nr. 1611/2023 datë 10.07.2023 e operatorit ekonomik “*Trimed*” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur*” me tender kryesor nr REF-71219-05-31-2023 ku ankimon Lotin 2 me objekt “**LOTI 2 F.V. PAJISJE SPITALORE PER URGJENCEN E SPITALIT RAJONAL VLORE**” me nr REF-71223-05-31-2023 me fond limit 6,633,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 23-06-2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Trimed*” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “Trimed” SHPK në ankesën nr 1611/2023 datë 10.07.2023 , pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

Kompania trimed shpk ka deklaruar që kompania prodhuese është IHC MEDICAL AS Komisioni I vlerësimit të ofertes vlerëson gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që kompania trimed nuk ka paraqit kontrata të ngjashme Referuar faturave apo kontaktat që ju keni paraqit objekti I prokurimit është pajisje mjekësore dhe jo pajisje laboratorike apo ortopedike si dhe material kitesh reagentesh laboratorit Ndersa katalogu I paraqit është në kushtet e një dokumenti ku nuk perputhen kodet e markuara të fotove me katalogun origjinal të kompanisë prodhuese Konkretisht Ju keni hedh kodin e produktit UOO98 shtrat elektrik spitalor ndersa në katalogon e faqes zyrtare ky kod nuk ekziston ndërkohe që foto e krevatit që ju keni hedh të markuar ka kodin UOO9 dhe ka keto specifitime (KVO gjykon që jeni në kushtet e përdorimit të një dokumenti të rreme neni 76 pika 5 I ligjit të prokurimit publik) TEKNIKE TIPARET ELEKTRIKE

- Katër pjesë, e lehtë për t'u pastruar, në një mënyrë që lejon dyshekun të marrë frymë. platformë e projektuar e shtratit prej metali.
- Lëvizja e kokës dhe këmbës me ndihmën e motorit elektrik.
- Lëvizja Trendelenburg falë mekanizmit të amortizatorit në këmbë.
- Sigurimi i sigurisë maksimale, i qëndrueshëm, i lehtë për t'u pastruar dhe ergonomik sistem kangjella metalike. ■ Panele të shtratit dhe dërrasave të veshura me melaminë.
- Sistemi i kokës që çmontohet lehtësisht, kur është e nevojshme, një tabelë ringjalljeje mund të përdoret edhe si
- Rrotat e përplasjes plastike rezistente ndaj goditjes.
- Sistemi i rrotave me diametër 125 mm, dy me frena.
- Bojë elektrostatische pluhur e lyster pasi është veshur me fosfat kundër korrozionit pjesë metalike. ■ Opsioni opsional i ngjyrës së melaminës. (RSX)
- Përmasat (W x L x H): 105 x 204 x 50 cm
- Përmasat e rekomanduara të shtratit: 85 x 190 x 12 cm
- Kapaciteti i sigurt i punës (Përfshirë krevatin dhe aksesoret): 230 kg
- Peshë : ~ 86 kg
- Vëllimi: 1.17 m³

■ Fuqia hyrëse: 230 V AC 50 / 60 Hz 50 W

■ Fuqia dalëse: 24 V DC

Keto specifikime nuk perputhen me specifikimet e kerkuara nga AK . 2 Ne vazhdim po keshtu KVO vlerson njesia multifunksionale me kodin e markuar nga ana juaj UO45.S ne katalogun online te kompanise IHC ky kod nuk gjendet. Nese shqyrtojme specifikimet po keshtu nuk perputhen me ato te faqes zyrtare qe ka komapni 3 Ne vazhdim ju keni deklaruar qe karroca me rrota per pajise srterile me kod U0973 POR NE KATAOLOG KY PRODUKT NUK EKZISTON

4 Po keshtu tek njesia multifunksionale ne foton e katalogut me kod UO45 nuk ka mbajtese e serumit pra nuk perputhen specifikimet teknike me ate qe ka kerkuar AK . 5 Produkti me kodin UO0 27 komodina e pacientit ne catalog ka keto specifikime SPECIFIKIMET E PËRGJITHSHME SPECIFIKIMET TEKNIKE

■ Trupi i drurit është i qëndrueshëm ndaj ujit dhe nxehtësisë.

■ Sirtar i dobishëm.

■ Mentasha dhe sistem hekurudhor jetëgjatë.

■ Sirtar i fortë dhe dorezë me kabina.

■ Sirtari dhe dera e laminuar janë të qëndrueshme ndaj ujit dhe nxehtësisë.

■ Me katër rrota (dy prej tyre me frena) mund të lëvizin lirshëm.

■ Gjerësia: 40 cm

■ Thellësia: 40 cm

■ Lartësia: 78.5 cm

■ Pesha: ~ 17 kg

■ Vëllimi : 0.13 m³ Pra sic shikohet dimensionet edhe permasat me ato qe ka kerkuar OE JANE TE PAPERPUTHSHME. 6 KODI U0 38 s eshte barrela e transportit qe ne catalog ka keto specifikime Gjerësia: 61 cm

■ Gjatësia: 204.5 cm

■ Lartësia: 79 cm

■ Pesha: përafërsisht 50 kg

■ Vëllimi : 1.20 m

Por ju keni deklaruar edhe perkthyer te tjera specifikime edhe dimensione te ndryshme nga katalogu I cili ka specifikimet e mesiperme te paperputhshme me specifikimet e AK Ne gjykojme qe ju jeni ne kushtet e perdorimit te nje dokumenti te rreme

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 11.07.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri